# DËSHMI ARKIVI

**A-447546**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas SHBA-së, Franca e Britania e Madhe u bëjnë thirrje për vigjilencë qytetarëve të tyre në Kosovë |
| ADRESA | `https://www.koha.net/arberi/edhe-franca-u-ben-thirrje-shtetasve-te-saj-ne-kosove-tregoni-vigjilence-qendroni-larg-tubimeve` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 02:50:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 10:50:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `12d08831d77f94cf351850e42488d9ea0974614f057cf62d0b430173093caf28` |
| TEKSTI | `351fe955c80da2fadbe735546cd783dab8de4c63c2a723bda10d792119f2a284` |
| PAMJA | `b180de6a5280f41da26821608b123f6ddd897603d35307b86d8c43fb8f57c8f8` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `016e8032487062971ad5667a8cd26da0af847931714a33210791944ab001392c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e059d51b19570df3bab28500acd4aaa952456ce184f2a2e88bb7ab7ef9d7b2bd` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/016e8032487062971ad5667a8cd26da0af847931714a33210791944ab001392c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

ARBËRI

# Pas SHBA-së, Franca e Britania e Madhe u bëjnë thirrje për vigjilencë qytetarëve të tyre në Kosovë



15 shtator 2026 12:50

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

(Lajm i përditësuar) - Edhe Franca e Britania e Madhe u kanë bërë thirrje shtetasve të tyre që ndodhen në Kosovë, që të tregojnë vigjilencë gjatë së mërkurës, përkatësisht në ditën kur do të shpallet aktgjykimi për katërshen e UÇK-së në Hagë.

Në një njoftim të Ministrisë së Jashtme të Francës thuhet se për këtë ditë janë planifikuar tubime të mëdha politike në të gjitha qytetet e Kosovës.

“Tubime – Thirrje për vigjilencë. Më 16 shtator, duke filluar nga ora 10:00, janë planifikuar tubime të mëdha politike në të gjitha qytetet e Kosovës. Shtetasit francezë këshillohen të qëndrojnë larg këtyre tubimeve. Ata duhet të shmangin udhëtimet jo të domosdoshme brenda qyteteve dhe në gjithë vendin deri në fund të ditës”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës.

Njoftim të ngjashëm ka bërë edhe ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë gjatë javës së kaluar.

“Gjatë javës së ardhshme do të ketë tubime të mëdha në Prishtinë dhe në qendra të tjera urbane, përfshirë më 12 dhe 16 shtator. Kjo mund të shkaktojë disa pengesa, përfshirë vështirësi në qarkullim dhe në transportin publik. Mbani veten të informuar për zhvillimet lokale, planifikoni kohë shtesë për udhëtim dhe qëndroni larg turmave të mëdha ose protestave”, thuhet në njoftim.

Edhe



Arbëri • 14 sht 2026
SHBA-ja fton amerikanët në Kosovë për kujdes më 16 shtator

Nesër, më 16 shtator, shpallet aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit.

Në prag të verdiktit të Speciales ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, edhe Ambasada e SHBA-së të hënën ka paralajmëruar shtetasit amerikanë që të mërkurën, më 16 shtator, t'i shmangin

Futboll.
Espi e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.
Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.
Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.
Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.
“Lufta nën akuzë...” demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.
Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

lëvizjet në afërsi të vendeve ku mund të ketë demonstrata. Po ashtu i ka bërë thirrje personelit të ambasadës që të mërkurën të mos i dërgojë fëmijët në shkollë.

#FRANCE #KOSOVE #16 SHTATOR #HASHIM THAÇI #KADRI VESELI #JAKUP KRASNIQI #REXHEP SELIMI

## Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 14 sht 2026

Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht ç'mund të ndodhë këtë javë në Kosovë




Arbëri • 14 sht 2026

Policia merr masa për 16 shtatorin: Mund të ketë kufizime të përkohshme të trafikut



Arbëri • 14 sht 2026

Ambasada amerikane ngre alarm për 16 shtatorin: Shmangni lëvizjet afër demonstratave



Arbëri • 5 o. më parë

Shqiptarët në Hagë e Kosovë po e presin në qiell të hapur vendimin për krerët e UÇK-së


KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.





Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!



+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë





Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.